**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**

# NJOFTIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit i njofton të gjithë operatorët ekonomik (duke ju referuar më poshtë si OE) , se nga fillimi i këtij viti-2023, OSHP ka lansuar Sistemin për Menaxhimin e Lëndëve (SML) për Organin Shqyrtues të Prokurimit, ku sipas këtij sistemi kalkulimi i afateve për ankesat e parashtruara do të behet në mënyrë elektronike nga vet sistemi.

Andaj njoftohen të gjithë OE-të që parashtrojnë ankesë në OSHP, që ankesa e tyre për tu proceduar për shqyrtim duhet të jetë e kompletuar ashtu siç specifikohet me nenin 111 të LPP-së.

Nëse OSHP e njofton ndonjë OE ankues, se ankesa e tyre nuk është plotësuar/ e kompletuar me tarifën e ankesës sipas pikës 10 të paragrafit 1 të nenit 111 të LPP-së, ai OE plotësimin e ankesës së tij duhet ta bej brenda aftit ligjor që parashihet në paragrafin 4 të nenit 111 të LPP-së.

OSHP ka hasur në disa raste ku OE ankues tarifën e ankesës së tyre nuk po e paguajnë në pajtim me nenin 69 të Rregullores nr. 002/2022 për Prokurim Publik ku dispozita e rregullores në fjalë specifikon:

Neni 69 Tarifa e ankesave:

69.1 në përputhje me nenin 108/A të LPP-se, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoriteti kontraktues.

69.2 Në përputhje me nenin 118 të LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro.

b. Kurdo që ankesa ndërlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit dhe shpërblimin e kontratave me çmime njësi (çmime të peshuara) shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës se parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro.

69.3 Pagesa do të bëhet me para të gatshme apo të barasvlershme në llogarinë e krijuar nga OSHP.

69.4 Ankesa do të hedhet poshtë nga OSHP nëse nuk shoqërohet me pagesë.

Andaj në ato raste kur OSHP i njofton OE ankues se ankesa e tyre nuk është e kompletuar me tarifën e sigurimit te ankesës në pajtim me nenin 69 të Rregullores nr. 002/2022 për Prokurim Publik, të njëjtit janë te obliguar që në pajtim me nenin 111të LPP-së te plotësojnë tarifën e sigurimit të ankesës së tyre, në të kundërtën ankesa e tyre do të hedhet si jo e plotë.

Ju njoftojmë, se nëse OE nuk e kompleton ankesën e tij brenda afatit ligjor te paraparë në dispozitën e lartcekur, ankesa e tij do të hedhet si jo e plotë dhe nuk do të procedohet më tutje për shqyrtim.

Për çdo ankesë të parashtruar duhet bashkëngjitet formulari standard i fletëpagesës së re së bashku me konfirmimin nga banka.

Nuk vlejnë fletëpagesat të cilat kanë qenë për ndonjë ankesë paraprake të dorëzuar në OSHP, qoftë për aktivitete te prokurimit te njëjtë apo për ndonjë aktivitet tjetër të prokurimit, pra çdo ankesë duhet ta ketë formulari standard të fletëpagesës së bashku me konfirmimin nga banka për secilën ankesë që parashtrohet nga OE në OSHP.

Paragrafi 4 i nenit 111 të LPP-së specifikon:

Nëse OSHP konstaton se ankesa nuk i plotëson kushtet sipas paragrafit 1 të këtij neni OSHP menjëherë do të informojë parashtruesin e ankesës me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, mbi karakterin e të metat që janë gjetur. Nëse afati për parashtrimin e ankesës ka skaduar ose skadon për më pak se katër (4) ditë, parashtruesi i ankesës do të ketë në dispozicion katër (4) ditë pas marrjes së njoftimit të tillë për të korrigjuar të metat e tilla dhe për të ri-parashtruar ankesën. Nëse afati për parashtrimin e ankesës akoma nuk ka skaduar dhe nuk skadon për më pak se dy (2) ditë, parashtruesi i kërkesës mund të ri-parashtrojë kërkesën në çdo kohë para skadimit të afatit për parashtrim.

**Prishtinë**

**Datë:07/07/2023**